



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.279/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj-kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bajram Sopjani, kandidat për anëtar në kuvend komunal të Prishtinës nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 22.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e parashtruar nga Bajram Sopjani, kandidat për anëtar në kuvend komunal të Prishtinës nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 20.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidates Bajram Sopjani nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, me të cilën pretendon se gjatë publikimit të rezultateve në nivel vendvotimi, është vërejtur se votat e mia nuk janë regjistruar të plota, ose janë vendosur gabimisht në kandidatë të tjerë në listë. Sipas parashtruesit të ankesës, kjo situatë përben parregullsi zgjedhore që cenon vullnetin elektorale të qytetarëve dhe rezultojnë tim personal. Problemet janë evidentuar në këto vendvotime:

1954, 1927, 1938, 1932, 1919, 1920, 1917, 1928, 1952, 1911, 1906, 1909, 1904, 1924, 1935, 1936, 1942, 1921, 1916, 1922, 1915, 1902, 1914, 1929, 1903, 1907, 1925, 1923, 1950, 1951.

Andaj, parashtruesi i ankesës kërkon hapjen e të gjitha vendvotimeve të lartpërmendura dhe rinumërimin ose verifikimin e votave si dhe korrigjimin e çdo parregullsie në regjistrim dhe publikim të rezultateve.

Në ankesë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dëshminë e motrës se tij e cila deklaron se e ka votuar mirëpo vota e saj nuk figuron në qendrën e votimit në Fakultetin Filologjik.

Në përgjigjen në ankesë të datës 21.10.2025, Komisioni Qendror Zgjedhor theksojnë se KQZ pas pranimit të kërkesës së PZAP menjëherë ka kontaktuar me KQZ e komunës së Prishtinës dhe ka pranuar këtë sqarim/përgjigje si në vijim: *"Sa i përket ankesës së kandidatit nga lista*

e Nisma për parregullsi në qendrat e votimit në Prishtinë. Procesi i votimit dhe numërimit në qendrat e votimit në Komunën e Prishtinës ka qenë i menaxhuar nga komisionerët e certifikuar nga KQZ dhe i monitoruar nga vëzhguesit e akredituar. Gjithashtu procesi i numërimit dhe ka qenë transparent dhe i monitoruar nga vëzhguesit e akredituar nga KQZ. Fletëvotimet gjatë numërimit janë ekspozuar përmes kamerave në ekran dhe secila votë është regjistruar në platformën digjitale". Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura lidhur me procesin e numërimit në QKN. Tutje KQZ ka theksuar se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimeshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë. Gjithashtu, ju njoftojmë se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve-QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shqyrtimit të ankesës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Bajram Sopjani, kandidat për anëtar në Kuvend të Komunës së Prishtinës nga subjekti politik NismaSocialdemokrate , në Prishtinë janë të pa bazuara për faktin se i njëjti nuk ka arritur që të vërtetoj, përkatësisht të dëshmoj faktin se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë të vetme përveç deklaratës së motrës së tij që përfshin të dhënat personale të saj dhe e cila është në kundërshtim me neni 4, paragrafi 1.3 i LZP-së, i cili përcakton se: liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim. Pavarësisht kësaj, parashtresuesi i ankesës nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet se ka ndodhur një veprim i tillë në QNR në Prishtinë. Kurse pretendimet e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete.

Paneli po ashtu edhe nga përgjigja e ofruar nga KQZ-ja vëren se *“Sa i përket ankesës së kandidatit nga lista e Nisma për parregullsi në qendrat e votimit në Prishtinë. Procesi i votimit dhe numërimit në qendrat e votimit në Komunën e Prishtinës ka qenë i menaxhuar nga komisionerët e certifikuar nga KQZ dhe i monitoruar nga vëzhguesit e akredituar. Gjithashtu procesi i numërimit dhe ka qenë transparent dhe i monitoruar nga vëzhguesit e akredituar nga KQZ. Fletëvotimet gjatë numërimit janë ekspozuar përmes kamerave në ekran dhe secila votë është regjistruar në platformën digjitale”* (shih të bashkangjitur deklaratën e (ZEKKZ).

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Bajram Sopjani, kandidat për anëtar në kuvend komunal nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur asnjë provë përkatësisht që dëshmon parregullsi gjatë futjes së të dhënave dhe rezultateve është vërejtur se regjistrimi në sistem të votave të kandidatit, nuk është i plotë dhe janë vendosur gabimisht në kandidatë të tjerë të listës, mbetet vetëm ne suaza të dyshimit dhe se nuk është mbështetur me asnjë prove që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenin 13 paragrafi 4 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZLAnr.279/2025 datë 22.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.